

GJYKATA THEMELORE NE Prishtine.-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli në P., të cilën e përfaqësoj sipas autorizimit N.B. juriste e diplomuar, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në P., të cilën e përfaqësoj sipas autorizimit V.B. jurist i diplomuar, me objekt kontesti shpërblim dëmi në shumën e përgjithshme prej 6,035.20 euro, pas përfundimit të seancës kryesore publike të datës: 26.10.2016, ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare të hartuar me shkrim nga paditësja dhe nga e paditura, me datë 18.11.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërishtë si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli në P..

I.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në P., që paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli në P., t’ia paguajë borxhin në emër të kompensimit të dëmit material në shumën prej 1,508.80 euro (njëmijë e pesëqind e tetë euro e tetëdhjetë cent), së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 12%, e cila do të llogaritet nga data 10.12.2013, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

II.REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë sa i përket shumës prej 4,526.25 euro.

III.DETYROHET e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej: 50.00 euro, në afatin kohor prej 7 (shtatë) nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli në P., ka paraqitur padi pranë kësaj Gjykate për shpërblimin e dëmit - kasko regres të pësuar nga aksidenti i komunikacionit me datë 11.01.2013, për çka edhe ka kërkuar nga gjykata t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 6,035.20 euro, me kamatë vjetore prej 12 % duke filluar nga data 10.12.2013 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në P..

I autorizuari i paditëses gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe pas marrjes së mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit Y.K. të datës 22.09.2016 si dhe pas sqarimeve shtesë nga i njëjti ekspert në seancën e datës 26.10.2016, ka mbet pranë padisë dhe kërkesëpadisë gjithashtu ka kërkuar kamatën vjetore prej 12 % duke filluar nga data 10.12.2013, e deri në pagesën definitive, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e saj ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurë i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës gjatë shqyrtimi gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesë padinë si për nga baza juridike lidhur me përgjegjësinë respektivisht shkaktarin e aksidentit po ashtu e ka kundërshtuar edhe lartësinë e dëmit. Duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Për zgjidhjen e kësaj çështje juridike Gjykata i administroi provat e propozuar nga palët në procedurë dhe atë duke filluar nga: raporti policior I datës 11.01.2013, urdhëres për transfer nga Banka E. e datës 16.04.2013, marrëveshja jashtë gjyqësore e datës 05.03.2013, kërkesa për rimbursimin e vlerës se paguar e datës 09.12.2013, njoftimi i datës 11.12.2013, paraqitja e dëmit në automjetin nga baza e sigurimit Auto Ka. e datës 14.01.2013, procesverbali mbi dëmtimin e automjetin e datës 11.01.2013, së bashku me fotodokumentacionin, polica e sigurimin kasko me numër 700977, e vlefshme deri me 19.06.2013, fatura e datës 13.02.2013, nga servisi I autorizuar Porche, ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti gjyqësor Y.K. e datës 22.09.2016.

Nga raporti i policisë, gjykata ka vërtetuar faktin se me datën 11.01.2013, ka ndodhur aksident trafiku ku ishin përfshirë E.K. në cilësi të vozitësit të automjetit "A" Shkoda Yeti me targa ..., i siguruar tek paditësja dhe i siguruari i të paditurës B.H në cilësinë të drejtuesit të automjetit "B" SEAT me targa ..., ku deri te aksidenti i trafikut është ardhur pasi që vetura "A" nuk e ka përshtatur shpejtsinë e lëvizjes dhe as kushteve atmosferike dhe njëkohësisht vetura "B" ka levizuar në shiritin e kundërt të lëvizjes ku vet vetura "A" është munduar që të mos ketë kontakt me veturë "B" e ka goditur shtyllën elektrike duke shkaktuar aksident në trafik me lëndime të lehta. Vlen të ceket se veturat nuk kanë pasur kontakt njëra me tjetrën.

Nga Polica e Sigurimit autokasko me nr...., gjykata vërtetoi faktin se automjeti Shkoda Yeti me targa ..., ishte i pajisur më policën e sigurimit të auto-përgjegjësisë e cila ishte valide.

Meqenëse e paditura e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë respektivisht përgjegjësinë lidhur me shkaktimin e dëmit në aksidentin e datës 11.01.2013, gjykata ka aprovuar propozimin e të autorizuarës së palës paditëse për nxjerrjen e ekspertizës së komunikacionit për të vërtetuar bazën juridike të kërkesë padisë nga eksperti Y.K. ku sipas mendimit dhe konstatimit të këtij eksperti të dhënë në ekspertizën e datës 22.09.2016, si dhe sqarimeve shtesë në seancën e datës 26.10.2016 ka vlerësuar dhe konstatuar se shkaktar kryesor i këtij aksidenti është vozitësi i veturës "A" i markës Shkoda Yeti, e siguruar me policë autokasko tek pala paditëse, me lëshimin e tij. Mirëpo në sqarimet e dhëna në seancën e datës 26.10.2016, ka shtuar se edhe i siguruari i të paditurës ka dhënë kontribut në shkaktimin e aksidentit por sa i përket ndarjes së përgjegjësisë nuk mund të jetë 50 me 50 pasi që shkaktar i drejtpërdrejt është i siguruari i paditëses.

Provat e propozuara dhe të administruara, deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, si dhe mendimin dhe konstatimin e ekspertit gjyqësor, gjykata i vlerësoi, të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPK-së.

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e paditësit, respektivisht të autorizuarit të tij dhe kundërshtimet e të autorizuarit të paditurës, gjykata duke iu referuar nenit 939 paragrafi 1 të LMD-së, sipas të cilit “me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit përgjegjës për kompensimin e dëmit”, paditësi ka të drejtë në kompensimin e dëmit deri në lartësinë e dëmit të paguar, meqenëse paditësi në bazë të sigurimit auto kasko ia ka kompensuar të siguruarit të tij dëmin e shkaktuar, rezulton se e paditura është përgjegjës ta kompensoi dëmin e shkaktuar nga i siguruari i saj deri në vlerën e kompensimit të paguar.

Meqenëse nga provat e administruara u vërtetua se paditësja ia ka kompensuar të siguruarit të saj kompensimin e dëmit ndërsa po ashtu u vërtetua se i siguruari i të paditurës ishte shkaktar i dëmit me përgjegjësi 25 %, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartë cituar dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e drejtë dhe e bazuar andaj të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palës së paditur lidhur me mbulueshmërinë e sigurimit në Kosovë, gjykata e refuzoj si të pabazuara këto pretendime me arsyetimin e cekur në këtë aktgjykim, e për më tepër e paditura nuk ka ofruar asnjë provë me të cilat do ti vërtetonte kundërshtimet e tij lidhur me mbulesën e sigurimit auto-kasko, ashtu si që parashihet në nenin 319 të LPK-së se palët në procedurë kanë për detyrë që t’i provojë faktet mbi të cilat i bazojnë pretendimet e tyre.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 par. 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjyqimit e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara nga pala paditëse dhe atë: për taksën e padisë shumë prej 50.00 euro, këto shpenzime të llogaritura në bazë të përgjegjësisë së aksidentit

Lidhur me pagesën e kamatës vjetore prej 12 % gjykata është bazuar në nenin 26 paragrafi 6 të Ligjit mbi sigurimin nga Auto përgjegjësia Nr. 04/L-018 e datës 29.07.2011.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 939 të LMD-së, si dhe 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE.
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.EK.nr.380/15 me datë 18.11.2016

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të të njëjtit, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.